



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**  
**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_ / 2020

**“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.03.1995 “KODI I  
PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

**Neni 1**

Në nenin 75/a, në shkronjën “a”, pas fjalës “dhe 319/e” shtohen fjalët “, si dhe neni 328 dhe 328/b i Kodit Penal”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**

**Gramoz Ruçi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_ / 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.01.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Pas nenit 52/a shtohet neni 52 /b me kete përmbajtje:

“Neni 52/b

Perjashtimi nga denimi për krimet në fushën e zgjedhjeve

Personi që ka kryer një ose me shume vepra penale të parashikuara në Kreun X të këtij Kodi i cili bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale për hetimin, si dhe për zbulimin e personave të tjerë, bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale ose autorë të veprave të tjera të lidhura, përjashtohet nga dënimi për veprën penale të kryer prej tij.”

**Neni 2**

Në nenin 328 shfuqizohen fjalët “në kundërshtim me ligjin”.

### **Neni 3**

Në paragrafin e fundit të nenit 328/a, shfuqizohen fjalët “në kundërshtim me ligjin dhe qëllimin e detyrës,”.

### **Neni 4**

Në nenin 328/b shfuqizohen fjalët “në kundërshtim me ligjin”.

### **Neni 5**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari  
Gramoz Ruçi**

[Shqiptaria.com]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI  
PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_ / 2020

**“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 108/2014, DATË 31.07.2014 “PËR  
POLICINË E SHTETIT”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 108/2014, datë 31.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

**Neni 1**

Shkronja “h” e nenit 17, e shfuqizuar me nenin 7 të ligjit nr. 58/2017, datë 20.04.2017, ndryshohet si vijon:

“h) zbaton detyrat në shërbim të administrimit të qetë dhe të rregullt të proceseve zgjedhore ose te referendumeve, bashkëpunon me administratën zgjedhore dhe raporton për veprimtarinë e strukturave të policisë në zgjedhje ose në referendume, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.”

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari  
Gramoz Ruçi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_ / 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në nenin 3, pika 6 pas fjalëve “korrupsion pasiv” shtohen fjalët, “përfshire edhe korrupsionin aktiv dhe/ose pasiv ne zgjedhje.”

**Neni 2**

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1  
Njësia përgjegjëse në KQZ

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve krijohet dhe funksionon njësia përgjegjëse për marrjen e sinjalizimeve dhe trajtimin e tyre, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.
2. Sinjalizimi mund paraqitet drejtpërdrejt në KQZ ose në Njësinë e Administrimit Zgjedhor, Në rastet kur sinjalizimi paraqitet në Njësinë e Administrimit Zgjedhor ajo ia përcjell atë menjëherë njësisë përgjegjëse në KQZ.
3. Në përfundim të hetimit administrativ të sinjalizimit, njësia përgjegjëse në KQZ, në rast se konstaton shkelje administrative vendos sanksione sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj. Për shkelje të ligjit penal paraqet kallëzimin përkatës në prokurori.

4. KQZ miraton me akt nënligjor procedurat administrative të hetimit të sinjalizimeve dhe afatet kohore të shqyrtimit të tyre.

### **Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**

**Gramoz Ruçi**

[Shqiptaria.com]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_ / 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016  
PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I  
I R E P U B L I K Ë S S E S H Q I P Ë R I S Ë**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në nenin 77, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1” me këtë përmbajtje:

“c/1) dosjet e hetimit ose, sipas rastit, të gjykimit për krimet që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve që Kodi Penal parashikon në minimum dënimin me jo me pak se një vit burg, duke përfshirë, për dosjet gjyqësore, edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, të cilat janë hetuar ose gjykuar nga magjistrati.”

**Neni 2**

Në nenin 82 shtohet shkronja “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje:

“d/1) për kryetarin e prokurorisë, dosjet e hetimit për krimet që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve që Kodi Penal parashikon në minimum dënimin me jo me pak se një vit burg, të cilat janë hetuar nën drejtimin e tij.”

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari  
Gramoz Ruçi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_ / 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.97/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në nenin 43, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) drejton dhe përgjigjet për hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton.”

**Neni 2**

Pas nenit 107 shtohet neni 107/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 107/1

Marrëdhëniet me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, i japin informacion KQZ-së për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Informacioni jepet me të dhënat për çështjet penale, personat nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkaku dhe ankimimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e



Lartë dhe rezultatin e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë dhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

2. Informacioni sipas paragrafit 1 të këtij neni përdoret nga KQZ-ja për nevojat e informimit publik për gjendjen dhe rezultatet e hetimieve penale për çështjet zgjedhore.
3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u përgjigjen kërkesave të KQZ-së për informacion jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës.

### **Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**

**Gramoz Ruçi**

[Shqiptaria.com]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_ / 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8580, DATË 17.02.2000 “PËR PARTITË POLITIKE”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I  
I R E P U B L I K Ë S S Ë S H Q I P Ë R I S Ë**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 24/1, neni 24/2, neni 24/3, neni 24/4 dhe neni 24/5 shfuqizohen.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Gramoz Ruçi**